

AKTI I THEMELIMIT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Metal 360”

Unë, Orges Elezi, i biri i Caushit dhe Fizes, i datelindjes 19-07-1987, banues ne **Helmas, Kavajë shtetas shqiptar** i identifikuar nga me **ID. I70719053G**, që në vijim do te quhet **“Ortak”**

Sot me date **05-01-2023**, vendosa te themeloj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“Metal 360”** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti I shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Perpunim metali, Import ,Eksport.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj,

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine ta emertoje

“Metal 360”

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne : rruga kryesore Princa Topia Shtodher, Helmas me numer ndertese 19,me numer postar 2509

2.3. Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tij Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin.

3.4.Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortakë ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
- 4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj
- 4.6. Ortaku ka te drejte te beje propozime, si dhe emeruje e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likuidatoret.

Neni 5

Kohezgjatja

- 5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te papercaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

- 6.1. Kapitali themeltar eshte **100.000** (njqind mije) leke.
- 6.2. Z. Orges Elezi ne cilesine e administratorit te shoqerise do te posedoje 1 kuote ,100% me vlere 100.000 leke.

Kreu IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

- 7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaku i Vetem ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe ekspeti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaku i Vetem i shoqerise

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1.Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori** i saj

z. Orges Elezi

8.2.Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte ripertitje ne perfundim te mandatit

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi I realizuar nga Shoqeria , mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakut te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

9.2.Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore

.Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise .

ORTAKU I SHOQERISE “Metal 360”

Orges Elezi

